

INFORMATIVA MBI TRAJTIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE

Në bazë të neneve 13 e 14 të Rregullores BE 2016/679 ("Rregullorja" o "GDPR") e D. Lgs. 196/2003, siç përshkruhet nga D. Lgs. 101/2018

1. Titullari për trajtimin e të dhënave

Titullari për trajtimin e të dhënave është Grandi Navi Veloci S.p.A., me seli ligjore në Palermo, Calata Maraini d'Italia, kodi fiskal dhe NIPT n. 13217910150 (më tej i quajtur "GNV" ose "Titullari").

Titullari mund të kontaktohet duke i shkruar në adresën: direzione@pec.gnv.it.

Titullari ka emëruar një Përgjegjës për Mbrojtjen e të dhënave personale (Data Protection Officer - DPO -) i cili mund të kontaktohet për çdo lloj informacioni ose kërkesë në adresën e-mail: dpo@gnv.it.

2. Tipologjitë e të dhënave të trajtuara

Titullari trajton të dhënat personale që kanë lidhje me të interesuarin e të dhënave, madje edhe të miturit, brenda kufijve të dispozitave ligjore dhe në përputhje me Kushtet e Transportit GNV. Këto të dhëna personale janë - si shembull por jo në mënyrë shteruese -: emri, mbiemri, adresa e vendbanimit, numri i telefonit, kodi fiskal, adresa/t e-mail, dokumentet e identifikimit; targat e automjeteve eventuale; të dhëna të tilla si numri i identifikimit të familjes, certifikata e familjes me shumë pjesëtarë, për vende specifike nisjeje ose destinacioni në rast se është e mundur të përfitohen zbritje çmimi në bazë të normativës lokale së aplikueshme; IBAN, të dhënat bankare/postare, të dhënat e kartave të kreditit, Log, adresa IP e prejardhjes (për shërbimet e përfituara nëpërmjet portalit web të GNV).

Gjatë fazës së rezervimit, normalisht nuk trajtohen të dhënat personale që u përkasin kategorive të veçanta, në përputhje me nenin 9, par. 1, të GDPR, me përjashtim të rastit kur të dhëna të tilla janë të nevojshme për ekzekutimin korrekt të shërbimeve të kërkuara nga transportuesi (shih, për shembull, rastin e pasagjerëve me lëvizshmëri të reduktuar): në këtë rast, në çastin e dorëzimit të të dhënave, jepet një informativë specifike e detajuar dhe i kërkohet të interesuarit miratimi specifik për trajtimin, në përputhje me nenin 9.2. a) të GDPR.

3. Qëllimet e trajtimit

Titullari ju informon mbi trajtimin e të dhënave tuaja personale dhe mbi të drejtat tuaja, në mënyrë që të Ju mund të shprehni pëlqimin tuaj në mënyrë të ndërgjegjshme, aty ku kërkohet.

Të dhënat tuaja personale (të paraqitura nga ju, nga palët e treta ose me prejardhje, brenda kufijve ligjor, nga listat publike) mund të trajtohen për qëllimet e mëposhtme:

1 – përmbushjen e detyrimeve të parashikuara nga ligji, mbi bazën juridike të nenit 6.1. c) GDPR (Rregullorja evropiane për mbrojtjen e të dhënave): domethënë për të përmbushur detyrimet e parashikuara nga ligji, nga një rregullore komunitare, si dhe nga dispozitat e lëshuara nga Autoritetet e legjitimuara sipas ligjit ose nga Organet kompetente të mbikëqyrjes ose kontrollit (në këtë rast miratimi Juaj nuk është i nevojshëm pasi trajtimi i të dhënave është i lidhur me përmbushjen e këtyre detyrimeve/dispozitave);

2 – ekzekutimin e detyrimeve kontraktuale të shitjes dhe asistencës (duke përfshirë ekzekutimin e të ashtuquajturës "rimbrojtje" dhe "code sharing", në rast se GNV ia komunikon të dhënat, ose ia merr ato, një transportuesi tjetër), baza ligjore e të cilit përbëhet nga neni 6.1. b) GDPR, domethënë: për të kryer detyrimet që rrjedhin nga kontratat në të cilat Ju jeni palë ose për të përmbushur, para ose pas lidhjes së kontratës, kërkesat tuaja specifike, gjithashtu me anë të teknikave të komunikimit në distancë, duke përfshirë një central telefonik të dedikuar (call center) dhe mbështetjen e Customer Care (kujdesit ndaj klientit), (në këtë rast nuk është i nevojshëm miratimi juaj, pasi trajtimi i të dhënave është në funksion të administrimit të marrëdhënies ose të ekzekutimit të kërkesave); aktivitete kundër mashtrimit; për të përdorur të dhënat e kontaktit (numrin e telefonit dhe/ose adresën e postës elektronike e-mail) të mbledhura gjatë fazës së rezervimit ose fazës tjetër pasuese për të dërguar, nëpërmjet instrumenteve të automatizuara (për shembull, nëpërmjet SMS, platformave të mesazheve të çastit ose rrjeteve sociale), komunikimet e shërbimit (si p.sh., komunikimet që mund të jenë të nevojshme për të administruar aspektet që lidhen me emergjencat sanitare aktuale dhe/ose në çdo rast që synojnë lehtësimin e operacioneve të imbakimit të pasagjerëve);

3 – mbrojtjen: për të vërtetuar, ushtruar ose mbrojtur një të drejtë në një seancë gjyqësore, mbi bazën juridike të neneve 6.1. f) dhe 9.2. f) GDPR;

4 aktivitet i analizës së brendshme të kompanisë; përfshin të gjitha veprimet e përpunimit të të dhënave që monitorojnë cilësinë e produkteve dhe shërbimet e ofruara për t'i përmirësuar vazhdimisht. Mes tyre përfshihet edhe dhënia e pyetësorëve që matin kënaqësinë e pasagjerit për të përmirësuar shërbimin, që GNV-ja mund t'i dërgojë me email në fund të udhëtimit.

Ligjshmëria e këtyre përpunimeve garantohet nga neni 6.1.f) i GDPR-së: interesi legjitim për kryerjen e këtyre analizave bazohet në nevojën për të verifikuar shërbimet e ofruara. Për të kryer analizat përpunohen vetëm të dhënat personale të nevojshme dhe, kur është e mundur, në mënyrë anonime. Personi i interesuar ka gjithmonë mundësinë të kundërshtojë këtë përpunim;

5 – tregtare ose shitje e drejtpërdrejtë e produkteve ose shërbimeve të GNV analogë me ata të blerë nga Ju: në lidhje me këtë, saktësohet se Titullari mund të përdorë, pa pëlqimin Tuaj, adresat e postës elektronike dhe postën me letër të dhënë nga ju në kontekstin e shitjes së një produkti ose shërbimi. Baza juridike e trajtimit për të dhënat tuaja për këto qëllime është interesi legjitim i Titullarit sipas nenit . 6.1. f) të GDPR. Në çdo rast, sipas nenit 21 të GDPR, Ju keni mundësinë që të kundërshtoni këtë trajtim në çdo kohë, fillimisht ose në rast komunikimesh të mëtejshme, në mënyrë të thjeshtë dhe falas edhe duke i shkruar Titullarit në këtë email: dpo@gnv.it;

6 – administrimin e pjesëmarrjeve në manifestime me çmime, mbi bazën juridike të nenit 6.1. b) GDPR: dorëzimi i të dhënave është i nevojshëm, pasi në mungesë të tyre, nuk do të jetë e mundur pjesëmarrja në manifestimin me çmime (një refuzim i mundshëm ka si pasojë përjashtimin e pjesëmarrësit nga procedura e lartpërmendur);

7 – tregtare: me miratimin tuaj paraprak, sipas nenit 6.1. a) të GDPR për t'ju dhënë informacione (edhe nëpërmjet teknikave të komunikimit në distancë të automatizuara ose jo si, të paraqitura vetëm si shembull, me korrespondencë postare, telefonata edhe nëpërmjet sistemeve të thirrjeve të automatizuara, telefaksit, postës elektronike, SMS ose MMS, platformat e mesazheve të menjëhershme ose rrjetet sociale ose lloje të tjera) mbi produktet, shërbimet ose nismat e GNV, për të promovuar këta të fundit, për të kryer kërkime të tregut edhe/ose për të kontrolluar cilësinë e produkteve ose të shërbimeve që Ju ofrohen (duke telefonuar ose dërguar pyetësorë); për të dërguar ftesa për të marrë pjesë në programet e besnikërisë, manifestime me fitim çmimesh dhe evente; përveç kësaj, në fund të udhëtimit, GNV do të jetë në gjendje të dërgojë, nëpërmjet postës elektronike, pyetësorë të pëlqimit që synojnë përmirësimin e shërbimit; baza ligjore e trajtimit në fjalë përfaqësohet nga interesi legjitim i Titullarit, në përputhje me nenin 6.1. f) të GDPR. Nëse i interesuari nuk dëshiron të marrë komunikime të tilla, ai mund të shprehë kundërshtimin e tij në çdo kohë duke shkruar në adresën dpo@gnv.it;

8 - profilimi: me miratimin tuaj paraprak, sipas nenit 6.1. a) të GDPR, për analizimin e zgjedhjeve tuaja të blerjeve dhe preferencave tuaja të sjelljes, on-line dhe off-line, me qëllim për të strukturuar sa më mirë komunikimin dhe propozimet tregtare të personalizuar, për të optimizuar vetë ofertën (edhe nëpërmjet analizave të blerjeve të bëra dhe/ose të sjelljeve gjatë udhëtimit me anije dhe/ose detaje të tjera të konsumit dhe/ose të dhënat që janë paraqitur në momentin e regjistrimit në Programin Fidelity dhe/ose në buletin dhe/ose për përgjigjet e dhëna për anketat e tregut), për të kryer analiza të përgjithshme me qëllim orientimi strategjik ose inteligjence tregtare dhe në përgjithësi për aktivitetin e profilimit.

Dorëzimi i të dhënave tuaja personale për qëllimet sipas numrave 2, 6, 7 dhe 8 është fakultativ. Në rast refuzimi nuk do të vërtetohet asnjë pasojë përveçse për qëllimet sipas pikës a), në lidhje me të cilën, mungesa e dorëzimit nuk do të mundësojë ekzekutimin e detyrimeve kontraktuale të shitjes dhe të asistencës nga ana e Titullarit.

4. Fidelity Card - Karta e Besnikërisë

Në kuadrin e aderimit në programin e besnikërisë së GNV, trajtimi i të dhënave ka për qëllim zhvillimin e aktiviteteve të renditura në vijim:

- a) lëshimin e Fidelity Card (Karta e besnikërisë) dhe administrimin e aktiviteteve që nuk mund të ushtrohen në mënyrë anonime dhe të nevojshme për të lejuar personat që e nënshkruajnë që të përdorin dhe njohin zbritjet e çmimeve dhe promovimet, të marrin pjesë në grumbullimin e pikëve dhe të kenë akses në përdorimin e shërbimeve të tjera ndihmëse nëpërmjet Kartës;
- b) kryerjen, shprehimisht me miratimin tuaj të dhënë me shkrim, për aktivitetet e marketingut të drejtpërdrejtë, si p.sh. dërgimin - nëpërmjet e-mail, SMS dhe MMS ose instrumenteve jo të automatizuar, si posta me letër dhe telefoni me operator - të materialeve publicitare dhe të komunikimeve me përmbajtje informative dhe/ose promovionale në lidhje me produktet ose shërbimet e furnizuara dhe/ose të Titullarit;
- c) kryerjen, me pëlqimin tuaj të dhënë me shkrim, për aktivitetet e profilimit individual ose të agreguara për

kërkimet e tregut që synojnë, për shembull, në analizën e zakoneve dhe zgjedhjeve të konsumit, në

përpunimin e statistikave për to ose vlerësimin e shkallës së kënaqësisë karshi produkteve dhe shërbimeve të ofruara.

Për qëllimet e përmendura në germën a) të pikës së mëparshme, dorëzimi i të dhënave nuk është i detyrueshëm, por përbën një kusht të nevojshëm dhe të domosdoshëm për lëshimin e kartës Fidelity Card: prandaj mungesa e dorëzimit të të dhënave sjell si pasojë pamundësinë për aplikuesin që të marrë Kartën.

Për qëllimet e përmendura në germën b) dhe c) të pikës së mëparshme, dorëzimi i të dhënave nuk është i detyrueshëm dhe refuzimi i mundshëm për të dorëzuar të dhëna të tilla dhe dhënia e miratimit përkatës do ta bëjë të pamundur për Titullarin që të zhvillojë aktivitetet e marketingut të drejtpërdrejtë dhe profilizimit të treguar në të, por nuk do të rrezikojë mundësinë që aplikuesi të përfitojë lëshimin e kartës Fidelity Card dhe të ketë qasje në benefiset që kanë lidhje me të.

5. Kujt i drejtohen dhe transferimi i të dhënave

Të dhënat personale ka mundësi t'i komunikohen:

- personelit të ngarkuar për trajtimin e tyre sipas nenit 29 të GDPR;
- subjekteve, enteve ose autoriteteve, titullarëve të pavarur për trajtimin, të cilëve u duhen komunikuar detyrimisht të dhënat tuaja personale, sipas dispozitave ligjore në fuqi ose urdhrave të autoriteteve (organeve të mbikëqyrjes, autoriteteve gjyqësore, shoqërive të sigurimit për furnizimin e shërbimeve të sigurimit) duke përfshirë edhe transportuesit e tjerë në rast ekzekutimi të të ashtuquajturës "rimbrojtje" dhe "code sharing";
- subjekteve që veprojnë zakonisht në cilësinë e përgjegjësve të trajtimit sipas nenit 28 të GDPR; lista a përditësuar dhe e plotë mund t'i kërkohet Titullarit duke e kontaktuar në adresat e mësipërme.

Për sa i përket transferimit të mundshëm të të dhënave personale drejt Vendeve të treta, Shoqëria bën të ditur se trajtimi do të bëhet sipas një prej metodave të lejuara nga ligji në fuqi, në përputhje me atë që parashikohet nga nenet nga 44 në 49 të GDPR. Është e mundur të kemi më shumë informacione, sipas kërkesës, nga Titullari në kontaktet e treguara më sipër.

6. Ruajtja dhe mënyra e trajtimit

Sigurohet që të gjitha trajtimet e të dhënave do të bazohen në parimet e vendosura nga GDPR, duke pasur parasysh në veçanti ligjshmërinë, korrektësinë dhe transparencën e trajtimit, përdorimin e të dhënave për qëllime të caktuara, të qarta dhe legjitime, në një mënyrë të përshtatshme në lidhje me trajtimin, duke respektuar parimet e minimizimit të të dhënave, saktësinë, kufizimin e ruajtjes, integritetin dhe privatësinë, përgjegjësimin (neni 5 i GDPR).

Të dhënat personale trajtohen nëpërmjet operacioneve të mëposhtme të: grumbullimit, regjistrimit, organizimit, strukturimit, ruajtjes, konsultimit, adaptimit ose modifikimit, përdorimit, shpërndarjes, zbulimit nëpërmjet transmetimit, rikuperimit, radhitjes, kombinimit, kufizimit, fshirjes dhe eliminimit të të dhënave.

Të dhënat personale i nënshtrohen përpunimit si atij në letër ashtu edhe atij elektronik.

Titullari do të trajtojë të dhënat personale për kohën e nevojshme për të realizuar qëllimet e treguara më sipër.

7. Të drejtat e të interesuarit

Në cilësinë e palës së interesuar në trajtimin e të dhënave në fjalë, ju keni të drejtat e mëposhtme njohëse dhe të kontrollit siç parashikohen nga Rregullorja (BE) 2016/679:

TË DREJTAT NJOHËSE	
E drejta për informativën neni 13-14 <i>duke konsideruar 58, 60</i>	Të interesuarit kanë të drejtë të marrin informacione të sakta mbi trajtimin e të dhënave të tyre personale. Informativa duhet të përmbajë këto informacione: <ul style="list-style-type: none">• Identitetin e Titullarit;• Identitetin e Data protection officer - DPO -• Qëllimet e trajtimit

	<ul style="list-style-type: none"> • Bazën juridike • Interesin e mundshëm ligjor që përbën bazën juridike • Detyrimet e mundshme ligjore ose kontraktuale në bazë të të cilave të dhënat do të jepen; • Rrethanat e qarkullimit të të dhënave (BE apo jashtë BE-së); • Kohëzgjatjen e trajtimit • Procesin (e mundshëm) vendimtar në bazën e trajtimit të automatizuar; • Të drejtat e të interesuarit: hyrja, ratifikimi, integrimi, fshirja, kufizimi, kundërshtimi, portabiliteti, ankesat praj Autoritetit Garant, revokimi i konsensusit
E drejta e aksesit neni 15 <i>duke konsideruar 63</i>	Personi i interesuar ka të drejtë të marrë nga Titullari për trajtimin e të dhënave konfirmimin nëse është duke u kryer apo jo një trajtim i të dhënave që i përkasin dhe, në këtë rast, të marrë aksesin në të dhënat personale
TË DREJTAT E KONTROLLIT	
E drejta e korrigjimit dhe integritetit neni 5 (1) (d), 16 <i>duke konsideruar 39, 59, 65, 73</i>	Personi i interesuar ka të drejtë të marrë nga titullari për trajtimin e të dhënave korrigjimin e të dhënave personale të pasakta në lidhje me të, pa asnjë vonesë të pajustificueshme. Duke marrë parasysh qëllimet e trajtimit, personi i interesuar ka të drejtë të përfitojë integrimin e të dhënave personale jo të plota, madje edhe duke dhënë një deklaratë plotësuese.
E drejta e eliminimit dhe harresës neni 17 <i>duke konsideruar 66-65, 68</i>	Personi i interesuar ka të drejtë të marrë nga Titullari i trajtimit fshirjen e të dhënave personale në lidhje me të, pa asnjë vonesë të pajustificuar dhe Titullari i trajtimit të të dhënave është i detyruar të fshijë të dhënat personale pa asnjë vonesë të pajustificuar, nëse ekziston një nga arsyet e përmendura në paragrafin 1 të nenit 17 të Rregullores.
E drejta e kufizimit neni 18 <i>duke konsideruar 67</i>	Personi i interesuar ka të drejtë të marrë nga Titullari i trajtimit kufizimin e trajtimit të të dhënave kur vërtetohen disa rrethana të caktuara.
E drejta për kundërshtim neni 21 <i>duke konsideruar 50, 59, 69-70, 73</i>	Personi i interesuar ka të drejtë të kundërshtojë në çdo kohë, për shkaqe që lidhen me situatën e tij të veçantë, trajtimin e të dhënave personale në lidhje me të, sipas Nenit 6, paragrafi 1, germa e) ose f), duke përfshirë profilizimin në bazë të këtyre dispozitave. Titullari për trajtimin e të dhënave heq dorë nga trajtimi i mëtejshëm i të dhënave personale, me përjashtim të hipotezës që mund të ekzistojnë arsye që e legjitimojnë trajtimin dhe se këto arsye mbizotërojnë mbi të drejtën e personit të interesuar për të kundërshtuar.
E drejta e portabilitetit neni 20 <i>duke konsideruar 68, 73</i>	Personi i interesuar ka të drejtë të marrë në një format të strukturuar, të përdorimit të zakonshëm si dhe të lexueshëm nga një pajisje automatike, të dhënat personale që i përkasin të cilat duhet t'i sigurohen nga Titullari i trajtimit të tyre. Ai gjithashtu ka të drejtë t'ia transmetojë këto të dhëna një Titullari tjetër për trajtimin e të dhënave, pa pengesa nga ana e Titullarit të trajtimit të të dhënave që ia ka dhënë ato, nëse: <ul style="list-style-type: none"> • trajtimi bazohet mbi miratimin në përputhje me nenin 6 paragrafi 1, germa a) ose në nenin 9, paragrafi 2, germa a) ose mbi një kontratë sipas nenit 6, paragrafi 1, germa b); dhe • kur trajtimi është kryer me mjete të automatizuara.
E drejta për të kundërshtuar dhe vendimet e bazuara vetëm në trajtimin e të dhënave neni 21 pika 2,3 neni 22 <i>duke konsideruar 70</i>	Në rast se të dhënat personale trajtohen për qëllime marketingu të drejtpërdrejtë, personi i interesuar ka të drejtë të kundërshtojë në çdo kohë trajtimin e të dhënave personale që i përkasin atij për këto qëllime, duke përfshirë edhe profilizimin në masën me të cilën ka lidhje me një marketing të tillë të drejtpërdrejtë. Personi i interesuar ka të drejtë që të mos i nënshtrohet një vendimi të bazuar vetëm mbi trajtimin e automatizuar, duke përfshirë edhe profilizimin, i cili prodhon efekte ligjore që kanë lidhje me të ose që ndikon në mënyrë analoge dukshëm në personin e tij.

Në cilësinë e tij si i Interesuar, personi i interesuar ka të drejtë gjithashtu të paraqesë një ankesë tek Autoriteti kompetent në përputhje me nenin 77 të Rregullores.

8. Procedura për ushtrimin e të drejtave dhe komunikimeve

personi i interesuar mund të dërgojë një kërkesë formale për të ushtruar të drejtat e veta ose një sinjalizim për mosplotësimin ose shkeljen e supozuar, duke dërguar një e-mail te: dpo@gnv.it.

Titullari për trajtimin e të dhënave personale merret me administrimin dhe përmbushjen e kërkesave për ushtrimin e të drejtave në përputhje me GDPR.

Saktësohet se:

- afati i fundit për respektimin e kërkesës së personit të interesuar është 30 ditë dhe mund të zgjatet për 60 ditë të tjera, nëse është e nevojshme, duke marrë parasysh kompleksitetin dhe numrin e kërkesave. Në këtë rast, Titullari informon personin e interesuar për këtë zgjatje afati dhe për arsyet e vonësës, brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës.
- Informacioni i dhënë nga personi i interesuar dhe komunikimet eventuale dhe veprimet e ndërmarra janë falas;
- nëse kërkesat e personit të interesuar janë qartësisht të pabazuara ose të tepruara, veçanërisht për shkak të natyrës së tyre të përsëritshme, titullari për trajtimin e të dhënave mund të:
 - a) kërkojë pagesën e një kontributi shpenzimesh të arsyeshme duke marrë parasysh kostot administrative të përballuara për të siguruar informacionet ose komunikimin apo të ndërmarrë veprimet e nevojshme; ose
 - b) të refuzojë përmbushjen e kërkesës.

Për çdo sqarim ose kërkesë në lidhje me trajtimin e të dhënave personale, është e mundur të kontaktoni në çdo kohë Titullarin e trajtimit të të dhënave ose DPO në adresën e e-mailit të treguar më lart.

Azhurnimi i fundit: tetor 2023.